



Prishtinë, 24 mars 2010
Kodi i ZRRE-së: V_228_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në dispozitat e Neneve 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Kërkesën e Ngrrohtores së Qytetit Gjakova Sh.A (N.Q Gjakova Sh.a) për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Licencave të N.Q Gjakova Sh.a-së, të datës 11 shkurt 2010,

Në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2010 nxori këtë:

VENDIM

I LEJOHET N.Q Gjakova Sh.a-së derogimi (shtyrje afati) në zbatimin e disa neneve dhe dispozitave të:

- Licencës për Gjenerim të Ngrohjes Qendrore
- Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Ngrohjes Qendrore dhe
- Licencës për Furnizim Publik me Ngrohjes Qendrore

1. Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të licencave të N.Q Gjakova Sh.a-së mbesin në fuqi.
2. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
3. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca me dispozitat dhe Nenet e droguar

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Theranda Beqiri, Anëtare

Blerim Koci, Anëtar

Shtojcë: Nenet e deroguara (shtyrje afati) me datë 24 mars 2010 të licencave të N.Q Gjakova Sh.a

Licenca e Gjenerimit të Ngrohtores Qendrore					
Nr.	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 27.05.09 deri me:	Derogimi i datës 24.03.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2.2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Gjenerimit të energjisë termale	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	31 dhjetor 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë.
2.	Neni 5-Pajtueshmëria me kodin e shpërndarjes, kodin matës dhe RRPFE*	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	31 shtator 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë e pajtueshmërisë.
3.	Neni 8 - Mjedisi	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	30 qershor 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë.
4.	Neni 11 - Obligimi i Sigurimit	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	30 qershor 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë.
Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Ngrohjes Qendrore					
Nr.	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 27.05.09 deri me:	Derogimi i datës 24.03.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Shpërndarjes	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	31 dhjetor 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë.
2.	Neni 4-Pajtueshmëria me kodin e shpërndarjes, kodin matës dhe RRPFE*	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	31 shtator 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet për ecurinë e nxjerrjes së dok.
3.	Neni 5-Detyrimet e të Licencuarit lidhur me pajisjet matëse	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë.
4.	Neni 12.1-Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	30 qershor 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë e nxjerrjes së dok.
5.	Neni 18-Shëndeti dhe Siguria	-	-	30 qershor 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe pastaj të dorëzohet raporti.
Licenca për Furnizim Publik me Ngrohje Qendrore					
Nr.	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 27.05.09 deri me:	Derogimi i datës 24.03.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	31 dhjetor 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë.
2.	Neni 5-Pajtueshmëria me kodin e shpërndarjes, kodin matës dhe RRPFE*	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	31 shtator 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë e pajtueshmërisë.
3.	Neni 7.4-Qeverisja e Detyrimeve të të Licencuarit	-	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë.
4.	Neni 8-Furnizimi me Njehsorë	-	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2010	Të merren iniciativa për plotësimin sa më të shpejt të këtij Neni, dhe të raportohet rregullisht për ecurinë.
*RRKPF		Rregulli mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji			